



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1415, datë 01.10.2010

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelcom sh.a në lidhje me Aktin Administrativë, Vendimi nr. 1349, datë 28.07.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për mbylljen e procedimit për zgjidhje mosmarrëveshje interkoneksioni të filluar me VKD nr. 1261 datë 28.04.2010 midis sipërmarrësit Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k dhe Albtelcom sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 01.10.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelcom sh.a në lidhje me Aktin Administrativë, Vendimi nr. 1349, datë 28.07.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për mbylljen e procedimit për zgjidhje mosmarrëveshje interkoneksioni të filluar me VKD nr. 1261 datë 28.04.2010 midis sipërmarrësit Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k dhe Albtelcom sh.a”

BAZA LIGJORE:

1. Germa ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);

2. Pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues i ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*K.Pr.A*)
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918 (*Rregullorja e Brendshme*);
4. “Rregullore për analizen e tregut”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 747, date 17.07.2009 (*Rregullorja*);
5. Rregullore për Aksesin dhe Interkoneksionin miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar (*Rregullorja*);
6. Vendimi nr. 1349, datë 28.07.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për mbylljen e procedimit për zgjidhje mosmarrëveshje interkoneksioni të filluar me VKD nr. 1261 datë 28.04.2010 midis sipërmarrësit Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k dhe Albtelecom sh.a” (*Vendimi*),

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa nr. 4036 prot, datë 30.08.2010 e Albtelecom sh.a (AKEP nr. 2734/3 prot, datë 30.08.2010) “Ankimi Administrativ” , (*Ankim Administrativë*);
2. Vendimi nr. 1349, datë 28.07.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për mbylljen e procedimit për zgjidhje mosmarrëveshje interkoneksioni të filluar me VKD nr. 1261 datë 28.04.2010 midis sipërmarrësit Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k dhe Albtelecom sh.a” (*Vendimi*),
3. Projektvendim i KD të AKEP për “Shqyrtimin e ankimit administrative të Albtelecom sh.a, në lidhje me Aktin Administrativ, Vendimi nr.1349, date 28.07.2010 të AKEP, “Për mbylljen e procedimit për zgjidhje mosmarrëveshje interkoneksioni të filluar me VKD nr. 1261 datë 28.04.2010 midis sipërmarrësit Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k dhe Albtelecom sh.a” (*Projektvendimi*);
4. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*);
si dhe,
5. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

1. Albtelecom brënda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 140 të ligjit nr.8485, ka bërë ankim administrativ për shfuqizimin/revokimin e Aktit Administrativ Vendimi nr.1349, date 28.07.2010 të AKEP, “Për mbylljen e procedimit për zgjidhje mosmarrëveshje interkoneksioni të filluar me VKD nr. 1261 datë 28.04.2010 midis sipërmarrësit Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k dhe Albtelecom sh.a”;

2. Albtelecom sh.a me shkresën nr. 4036 prot, datë 30.08.2010 e Albtelecom sh.a (AKEP nr. 2734/3 prot, datë 30.08.2010) “Ankimi Administrativ ndaj vendimit nr.1349 datë 28.07.2010 të KD te AKEP “Për mbylljen e procedimit për zgjidhje mosmarrëveshje interkoneksioni të filluar me VKD nr. 1261 datë 28.04.2010 midis sipërmrresit Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k dhe Albtelecom sh.a” kërkon shfuqizimin/revokimin e Aktit Administrativ Vendimi nr.1349, date 28.07.2010 të AKEP;
3. Albtelecom thekson se gjatë seancës dëgjimore të AKEP midis palëve u diskutua se tarifa e tranzitimit do të ishte në negociata komerciale midis paleve, duke arsyetuar pretendimet e Albtelecom per kostot që ka për ofrimin e këtij shërbimi. Por ne Vendimin nr. 1349 datë 28.07.2010 dhe se kjo pike e diskutuar në seancen dëgjimore nuk është përfshirë;
4. Albtelecom duke i'u referuar praktikave ndërkombëtare sqaron se, ky shërbim ka për qëllim “long distance calls” dhe është një alteramntivë e konsumatorit shqiptar për telefonatat me distance nderkombëtare, shërbim të cilin Albtelecom e ofron nen kosto, ndërkohe ATN e ofron këtë shërbim për përdoruesit e kartës së tij, duke tranzituar nëpërmjet palëve të tjera, kështu që përdoruesit të kartës ATN i ofrohet kjo mundësi, ndaj vendosja e nj; detyrimi të tillë i shërben vetëm interesave komerciale te ATN dhe jo përdoruesit fundorë;
5. Për sa më sipër Albtelecom e konsideron jo propocionale vendosjen e një detyrimi të tillë, duke patur parasysh vështirësitë teknike për implementim si dhe shkaktimin e kostove shtesë për implementimin dhe realizimin e tij;
6. Albtelecom pretendimet e mësipërme i mbështet në:
 - Parimin e përcaktuar nga praktikat ndërkombëtare dhe nga ligji për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë;
 - Nenin 31 e vijues të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2010 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
 - Nenin 2 dhe 4 të dokumentit “Rrregullore për Akses dhe Interkoneksion”;
 - Vendimi nr. 1348 date 26.07.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP i ankimuar nga Albtelecom dukë i'u referuar pikës 4.3 te tij;
7. Gjithashtu Albtelecom thekson se, ky shërbim mund të ofrohet vetëm në bashkëpunim edhe me palët terminuese të thirjeve që janë operatorët celualare, por Vendimi 1349 datë 28.07.2010 i drejtohet vetem Albtelecom dhe ATN, ndërsa opertoret e tjerë nuk kanë marrë njoftim për këtë vendim dhe si rrjedhoje dispozitat e këtij vendimi nuk kanë fuqi detyruese për palët e interesuara, duke bërë të pamundur për Albtelecom zbatimin e detyrimit sipas përcaktimeve dhe afatit të vendosur nga AKEP;
8. Pëfundimisht për sa më sipër Albtelecom kërkon pezullimin dhe shfuqizimin/revokimin e aktit administrativ Vendimi nr. 1349 date 28.07.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP;
9. Ankimimi administrativ në lidhje me VKD nr.1349, date 28.07.2010, pezullon efektet e tij, nga data e depozitimit të ankimit në AKEP deri në marrjen e një vendimi përfundimtar të AKEP mbi ankimimin administrative;
10. AKEP, bazuar në shqyrtimin e pretendimeve të ankimit administrative, në lidhje me Vendimin nr. 1349, datë 28.07.2010 të AKEP, gjykon se:

- Me VKD nr. 1349, datë 28.07.2010 ka pranuar kërkesën Albtelecom duke i përfshirë kërkesat e Albtelecom në VDK nr. 1349 në pikën 4 të tij si më poshtë vijon:

Zbatimi i detyrimeve të mësipërme të kryhet nëpërmjet:

- a. Nënshkrimin të marrëveshjes së interkoneksionit të re apo të amenduar midis Albtelecom dhe Alban Tirana Nascendo, bazuar në ofertën referencë të përditësuar të Albtelecom sipas përcaktimeve të Vendimit nr.1348, datë 26.07.2010;*
 - b. Nënshkrimin të marrëveshjeve të interkoneksionit të reja apo të amenduara midis Albtelecom dhe operatoreve celulare me FNT, bazuar në ofertat referencë respektive të interkoneksionit të operatoreve Albtelecom, Vodafone Albania, AMC dhe Eagle Mobile të përditësuara sipas përcaktimeve të Vendimeve përkatëse për shpalljen me FNT të tyre, dhe sipas negociatave komerciale për thirrjet drejt Mobile 4 Al;*
 - c. Kapacitetet e interkoneksionit midis Alban Tirana Nascendo/OSHKP-ve të tjerë dhe Albtelecom si edhe midis Albtelecom dhe operatorëve celulare të përcaktohen sipas kushteve të ofertave referencë të interkoneksionit dhe pa-diskriminim në raport me operatorët e rrjeteve publike fikse/celulare;*
- AKEP në seancën dëgjimore të zhvilluar me palët e interesit pra edhe me operatorët mobile mbi këtë mosmarrëveshje midis Albtelecom dhe ATN dhe për sa më sipër AKEP në zbatim të gurmës b të nenit 57 të K.Pr.A si më poshtë vijon:

“Perjashtimi nga detyrimi për të njoftuar”:

Administrata nuk ka detyrim për të njoftuar në lidhje me aktet administrative në rastet e mëposhtme:

- b) **Kur pala e interesuar, merr pjesë në zhvillimin e procedimit administrativ dhe manifeston njohuri të plota në lidhje me aktin administrativ në fjalë.***
- AKEP në pikën 6 të Vendimit nr. 1349, datë 28.07.2010 ka vendosur që, **“ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al”**, dhe për sa më sipër palët e interesuara mund të gjejnë vendimin nr. 1349 datë 28.07.2010 të publikuar në domain publik, në faqen zyrtare të Internetit të AKEP: www.akep.al;

Njëkohësisht, Albtelecom nuk ka depozituar prova që operatorët celulare kanë kundërshtuar pranimin e thirrjeve OSHKP-Celulare të tranzituara nga Albtelecom, për shkak të mosnjoftimit të Vendimit nr.1349, datë 28.07.2010.

- Në lidhje me afatin kohor të përcaktuar nga AKEP në pikën 5 të vendimit:

Ofrimi nga Albtelecom i shërbimit të tranzitimit të thirrjeve të ofruesve të kartave me parapagim, të gjeneruara nga abonentët e Albtelecom, drejt rrjeteve celulare, të behet efektiv pas nënshkrimin të marrëveshjeve të cituara në pikën 4 më sipër, dhe në të njëjtën kohë për Alban Tirana Nascendo dhe ofruesit e tjere të shërbimeve me karte të parapaguara me të cilat është nënshkruar marrëveshja/amendimi përkatës i cituar në pikën 4, por jo më vonë se 1.11.2010.

AKEP gjykon se afati kohor prej 3 muajsh i vendosur për implementimin e shërbimit të tranzitimit OSHKP-Celulare, është i arsyeshëm.

- Në lidhje me tarifatat e tranzitimit, AKEP me VKD nr.1348, datë 26.07.2010, ka miratuar tarifatat e tranzitimit në rrjetin Albtelecom.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S :

1. Të rrëzojë kërkesën ankimore nr. 2734/3 prot, datë 30.08.2010 të Albtelecom sh.a.
2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**